



KOLEGJI - COLLEGE  
**PJETËR BUDI**  
PRISHTINË - PRISHTINA

## **MASAT NDËRKOMBËTARE KUNDER PASTRIMITTEPARASË DHE LIDHJA ME EVAZIONIN FISKAL - KOSOVA**

**MSc. Shkelqesa Çitaku, PhD. (Cand),**

University of Prishtina, Faculty of Law, Republic of Kosova

[Shkelqesa@gmail.com](mailto:Shkelqesa@gmail.com)

### **Abstrakt:**

Edhe pse pastrimi i parave dhe evazoni fiskal janë krime të ndryshme, ka një lidhje në mes tyre. Suksesi i çdo krimi varet nga aftësia për të fshehur gjurmët financiare të ardhurave. Pastruesit e parave kërkojnë për të transformuar të ardhurat e fituara në mënyrë të paligjshme në të ardhura ligjore duke shmangur zbulimin dhe mbledhjen e tatimeve nga ana e autoriteteve tatimore. Edhe pse evazonit fiskal dhe pastrimi i parave janë procese mjaft të dallueshme, ato ndajnë të njëjtat teknika të sofistikuar që mbështesin njëra-tjetrën.

Paraja e fituar lehtësisht, sidomos ajo që rrjedh nga evazoni fiskal, apo krimi në përgjithësi shoqërohet me veprimtari të tjera kriminale si pastrimi i parave, korrupsioni etj. Evazoni fiskal nga pastrimi i parasëduhet të adresohen në mënyrë efektive për një numër arsyesh. Në fillim ajo privon shtetet nga rritja e të ardhurave të mjaftueshme për këtë arsye duhet parandaluar me politika sociale, ekonomike, mjedisore, e të tjera. Evazoni fiskal dëmton përpjekjet e qeverisë për të promovuar mirëqenien dhe kohezionin social, por e pengon atë edhe nga kryerja e funksionit të saj shoqëror. Për më tepër, dëmton kredibilitetin e institucioneve demokratike, duke prekur besimin e qytetarëve në tek një qeveri legjitime, demokratike.

**Fjalë kyçe:** *Pastrimi i parasë, evazoni fiskal, korrupsioni*